


Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera- Office of the Prime Minister

AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË  
AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO  
FOOD AND VETERINARY AGENCY

 Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë  Manuali	<b>PSO</b> <b>Procedurat Standarde të Operimit për marrjen e mostrave të dheut për identifikimin e nematodave të patates që formojnë cista <i>Globodera rostochiensis</i> dhe <i>Globodera pallida</i></b>	<b>Dok.-Nr.:07-109-005</b> <b>Versioni:</b> 1.0. <b>Faqe:</b> 7 <b>Statusi:</b> 31.01.2019.
--	---	--

<b>Titulli:</b>	Procedurat Standarde të Operimit për marrjen e mostrave të dheut për identifikimin e nematodave të patates që formojnë cista <i>Globodera rostochiensis</i> dhe <i>Globodera pallida</i>
<b>Fushëveprimi:</b>	Administrata Fitosanitare
<b>Fjalët kyçe:</b>	Monitorimi, inspektimi, dheu, pajisjet, nematodat e patates që formojnë cista, skema, mostrimi, fusha, patate, fidanishte, raporti i inspektimit, laboratorit, testimi, kërkesa për testim, historiku i fushës
<b>Legjislacioni dhe dokumentet relevante</b>	LIGJI NR. 04/L-120 PËR MBROJTJEN E BIMËVE
<b>Referencat e tërthortë</b>	Procedura për mostrim të dheut Përgatitja e mostrës për testim laboratorik Masat fitosanitare në rast të identifikimit të nematodave të patates që formojnë cista Mbajtja e historikut të fushës për mbikëqyrjen e shpërthimeve

<b>Hartuar nga:</b>	Naim Delijaj – Inspektor fitosanitar Ismet Fejzullahu – Shef i Sektorit të Inspektoratit Fitosanitar - AUV Burim Ahmeti - Inspektor fitosanitar Islam Mulaj – Inspektor fitosanitar kufitar Agita Pence - ekspert i shtetit anëtar të BE Gunita Škupele - ekspert i shtetit anëtar të BE	<b>Data:</b> 28.01.2019.
<b>Bashknëshkruar nga:</b>	Ilirjana Zymberaj – Drejtoreshë e Inspektoratit të AUV	<b>Data:</b> 18/03/2019
<b>Miratur nga:</b>	Kujtim Uka – Menaxher i Cilësisë	<b>Data:</b> 18/03/2019

<b>Përfundimisht nënshkruar nga:</b>	Valdet Gjinoçci - Kryeshef Ekzekutiv i AUV-së 	Data: 19.03.2019
<b>Në fuqi që nga:</b>		Data:

<b>Arsyeja për përditësimin e fundit:</b>		Data:
<b>Përditësimi i fundit:</b>		Data:
<b>Përditësimi i bashkë nënshkruar nga:</b>		Data:
<b>Miraturar nga:</b>		Data:
<b>Përditësimi përfundimisht i nënshkruar nga:</b>		Data:

#### Permbajtja

I Çështjet e përgjithshme .....	3
II Koha e marrjes së mostrave .....	3
III Procedura e përgjithshme e mostrimit të dheut .....	4
IV Përgatitja e mostrave për dërgim në laborator .....	4
V Veprimi në rast të identifikimit të nematodave të patates që formojnë cista .....	4
Aneks 1 .....	5
Aneks 2 .....	6
Aneks 3 .....	7

## **Procedurat Standarde të Operimit për marrjen e mostrave të dheut për identifikimin e nematodave të patates që formojnë cista *Globodera rostochiensis* dhe *Globodera pallida***

### **I Çështjet e përgjithshme**

1. Kjo procedurë e operimit përcakton procedurën se si inspektori fitosanitar (në tekstin e mëtejshëm inspektori) i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (në tekstin e mëtejshëm AUV) merr mostra të dheut për identifikimin e nematodave të patates që formojnë cista *Globodera rostochiensis* (Woll) Behrens (popullatat evropiane) dhe *Globodera pallida* (Stone) Behrens (në tekstin e mëtejshëm nematoda të patates që formojnë cista).
2. Për kryerjen e mostrimit të dheut, inspektorit duhet t'i sigurohen pajisjet e nevojshme: qese polietilene, lugë për marrjen e mostrave, kapakët për mostra etj.
3. Para se të fillojë marrja e mostrave, pajisjet dhe këpucët që përdoren për marrjen e mostrave të dheut duhet të pastrohen tërësisht nga dheu.
4. Fusha është zonë e qarkullimit bimor në një fermë, e cila mund të dallohet nga zonat e tjera të tokës dhe ku është e mundur të kryhen masat fitosanitare pa ndarjen e zonave fqinje të qarkullimit të bimëve.
5. Marrja e mostrave kryhet në përputhje me planin vjetor të punës së AUV në vendet e mëposhtme:
  - 5.1 në ferma që prodhojnë farëra të patates, në fusha ku planifikohen të rriten farëra të patates dhe patate të destinuara për qëllime tjera (konsumim, përpunim);
  - 5.2 në ferma që prodhojnë patate për konsum dhe përpunim për qëllime monitorimi;
  - 5.3 Në fushë, ku planifikohet të rriten bimët të cilat janë nikoqire të nematodave të patates që formojnë cista në përputhje me Udhëzimin përkatës Administrativ të MBPZHR.
6. Mostrat e marra të dheut përgatiten në përputhje me kërkesat e këtij udhëzuesi dhe dërgohen për testim në Institutin Bujqësor të Kosovës ose laborator të akredituar, kontraktuar nga AUV (në tekstin e mëtejshëm laborator).
7. Hartohet një skemë (plan) për çdo fushë ku kryhet mostrimi i tokës. Zona ku është marrë çdo mostër dhe numri i mostrës duhet të shënohen në këtë skemë.
8. Lista e mostrave të marra të tokës plotësohet sipas Aneksit 1 dhe i bashkangjitet kopjes së raportit të inspektimit që mbahet nga inspektori.

### **II Koha e marrjes së mostrave**

9. Marrja e mostrave të dheut në ferma që prodhojnë farëra të patates dhe në fusha që prodhojnë bimët nikoqire të nematodave të patates që formojnë cista (në tekstin e mëtejshëm bimët nikoqire) kryhet para mbjelljes së patateve në vjeshtë apo pranverë dhe para mbjelljes së bimëve nikoqire në një fushë të re.
10. Marrja e mostrave përgjatë monitorimit mund të kryhet në fushën ku planifikohet të rriten patatet, para mbjelljes së patateve në vjeshtë apo pranverë ose pas vjeljes së patateve.

### **III Procedura e përgjithshme e mostrimit të dheut**

11. Nga sipërfaqe prej një (1) ha, merret një (1) mostër dhe e madhësisë të paktën 1.5 litra.

12. Do të përdoret skema e mëposhtme:

çdo hektar ndahet në pjesë identike drejtkëndëshe, secili seksion me gjerësi prej jo më pak se 5 metra dhe gjatësi jo më të madhe se 20 metra, merret një lugë nga secila pjesë e tillë drejtkëndëshe (Aneksi 2). Mostra e dheut përbëhet nga të paktën 100 lugë, ku madhësia e lugës është 15ml.

13. Nëse sipërfaqja e fushës është më pak se 1 hektar, mostra e dheut merret në të njëjtën mënyrë si mostra e përmendur në paragrafin 12. Madhësia e mostrës së dheut dhe numri i lugëve duhet të reduktohet proporcionalisht madhësisë së fushës, por madhësia e mostrës së dheut nuk duhet të jetë më pak se 0.1 litra.

14. E gjithë mostra përdoret për testim laboratorik.

#### **IV Përgatitja e mostrave për dërgim në laborator**

15. Një mostër dheu (1.5l) e marrë prej 1 hektar vëhet në një qese të veçantë polietileni. Mostrat e marra nga secila fushë vëhen së bashku në një qese më të madhe të polietilenit, por nuk kombinohen me mostrat nga fushat e tjera.

16. Një kërkesë e vetme laboratorik shtohet për një grup të mostrave të marra nga një fushë. Të gjithë numrat e mostrave të marra në këtë fushë renditen.

#### **V Veprimi në rast të identifikimit të nematodave të patates që formojnë cista**

17. Kur nematodat që formojnë cista me përmbajtje të gjallë identifikohen në testet laboratorike, masat fitosanitare zbatohen në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MBPZHR për kontrollin e nematodave të patates që formojnë cista.

18. Historiku i fushës krijohet për fushën e pushtuar (Aneksi 3). Në historikun e fushës, informacionet përkatëse tregohen për vitet gjatë të cilave zbatohen masat fitosanitare.

19. Nëse nematoda të patates që formojnë cista me përmbajtje jo të gjallë identifikohen në testet laboratorike, masat fitosanitare nuk zbatohen.

Aneks 1

Skema e marrjes së mostrave të dheut

